

'WUS AUSTRIA' DHE UP FILLOJNË PROJEKTIN PËR PHD

Reformim i planprogramit për PhD

Në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës të hënën është mbajtur Takimi Nismëtar për TEMPUS projektin "PhD në Shkenca të Ushqimit dhe Teknologji të Ushqimit dhe në krijimin e kapaciteteve për reformë në PhD në Universitetin e Prishtinës"



Projekti financohet nga Programi TEMPUS i Komisionit Evropian

Tribuna
Prishtinë, 17 janar

Me qëllim të reformimit të planprogrameve të nivelit të studimeve PhD në Universitetin e Prishtinës, të hënën është mbajtur një takim në mes të UP-së dhe 'WUS Austria'. Qëllimi i këtij projekti është ta mbështesë reformën në planprogram të doktoratës (PhD),

si dhe ngritjen e kapaciteteve në Universitetin e Prishtinës, në përputhshmëri me procesin e Bolonjës dhe me zhvillimet e fundit evropiane, me qëllim që të mbështetet integrimi i Kosovës në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Rektori i UP-së, Mujë Rugova, ka thënë se fillimi i këtij programi të doktoratës do të kontribuojë në arsimimin dhe përgatitjen e ekspertëve të rinj në fushën e teknologjisë së ushqimit. "Përveç kësaj, qëllimi është që të

krijohet një praktikë model në Universitetin e Prishtinës ku ofrohen programe të doktoratës të cilat bazohen në standardet më të larta evropiane, në planprogram bashkëkohor e në trend me zhvillimet e fundit në shkencë, hulumtim shkencor, mobilitet të studentëve, ndërkombëtarizim dhe sigurim të cilësisë". Nderkohë, drejtori i zyrës së 'WUS Austria' në Kosovë, But Dedaj, është shprehur se rëndësia e këtij projekti, përfitues i të

cilit është Universiteti i Prishtinës, përveç në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe reformën në planprogram, ka rëndësi të madhe edhe në ndërkombëtarizimin e Universitetit të Prishtinës.

Arsimim evropian në UP

Nderkohë, drejtori i zyrës për Arsim të Lartë në MASHT, Avdulla Alija, ka thënë se Ministria e Arsimit dhe veçmas UP po bëjnë një punë të madhe në procesin e konsolidimit të mekanizmave për të siguruar një arsim të lartë cilësor, të krahasueshëm dhe konkurrent në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Kontraktues i këtij projekti është Universiteti i Grazit, kurse koordinatori është 'WUS Austria'. Ndërsa përfitues direkt i projektit është Universiteti i Prishtinës.

Partnerët e tjerë të projektit janë Universiteti Teknik i Munihut, Universiteti i Granadas, Universiteti Vassa. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës, Agjencioni Kosovar i Akreditimit, Shërbimi Austriak i Studentëve, Unioni i Pavarur i Studentëve i UP së dhe Lista e Studentëve "Reforma".

"TRIBUNA SHQIPTARE", 18/01/2011